

V E N D I M
Nr.217, datë 23.4.1999

**PËR KRITERET E NEGOCIMIT TË INVESTITORËVE BANKARË DHE FINANCIARË, PËR
PRIVATIZIMIN E BANKËS KOMBËTARE TREGTARE**

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe të nenit 2, të ligjit nr. 8433, datë 21.12. 1998 "Për përcaktimin e formës dhe formulës së privatizimit të Bankës Kombëtare Tregtare, Sha", me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ministria e Financave të njoftojë investorët bankarë dhe financiarë, ndërkombëtarë, të interesuar për privatizimin e Bankës Kombëtare Tregtare, për investorin strategjik, fitues.

2. Investorët bankarë dhe financiarë, ndërkombëtarë, të interesuar, pas komunikimit dhe negociimeve ndërmjet tyre dhe me investorin strategjik, të bëjnë "due diligence" të Bankës Kombëtare Tregtare, dhe, së bashku, të përgatisin një propozim të përbashkët, që do të shërbejë si bazë negociimi.

3. Pas përfundimit të veprimeve, të parashikuara në pikën 2, të këtij vendimi, grupi i investorëve të fillojë negociimet me ministrin e Financave, i cili të ndihmohet nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, për privatizimin e Bankës Kombëtare Tregtare.

4. Negociimet të zhvillohen në përputhje me aneksin 4, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 834, datë 30.12.1998 "Për procedurat e privatizimit të Bankës Kombëtare Tregtare".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko